


Tuneli i Porto Palermos shndërrohet në muze



Vlorë, 12.07.2011 17:11

Për shumë vjet ka qenë një vend i ndaluar, sot i braktisur. Projekti i studios "Terragni" synon të rivitalizojë tunelin e nëndetëseve në Porto Palermo, njofton Koha.

Pas studimit, është menduar si varianti më i mundshëm, një muze i Luftës së Ftohtë. Një grup i ekspertëve po punojnë për shndërrimin e bazave ushtarake të braktisura në muze dhe Porto Palermo është një prej tyre.

Një përvojë të ngjashme e kanë provuar disa vite më parë në Toronto, ku një tunel lufte e kthyen në një vend turistik. Tuneli i ri është i gjatë 650 metra dhe 12 metra i lartë dhe ndodhet në pjesën veriore të Porto Palermos, 60 kilometra larg Vlorës. Porta e tunelit, e tëra beton, peshon rreth 32 tonë.

Të gjithë gjatësinë e këtij tuneli, arkitektët mëtijnë ta kthejnë në një muze që do të jetë një reflektim përmes dokumenteve që përcjellin ngjarjet e Luftës së Ftohtë.

"Në Shqipëri ka me qindra struktura të braktisura të Luftës së Ftohtë, siç është edhe tuneli, në një zonë mjaft të bukur në Jug të Shqipërisë. Ka shumë struktura të tillë që prishin në njëfarë mënyre panoramën, që i përkasin së kaluarës", thuhet në deklaratën e ekspertëve italianë.